



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 681/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Sherif Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i parashtruar nga Sherif Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, në Vendvotimet: 2205E/01D në fshatin Belincë, 2212E/01D në Zborc, 2204E/01R, 2204E/02D në Muzeqin, 2202E/01R, 2202E/02R, 2202E/03D në Petrovë, 2215E/01R, 2215E/02D, në Mollopol të Komunës së Shtimes.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar apelin me datë 09.11.2017 në ora 14:20, nga Sherif Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime me të cilën pretendon se në vendvotimet: 2205E/01D në fshatin Belincë, 2212E/01D në Zborc, 2204E/01R, 2204E/02D në Muzeqin, 2202E/01R, 2202E/02R, 2202E/03D në Petrovë, 2215E/01R, 2215E/02D, në Mollopolc të Komunës së Shtimes, ka pasur parregullsi gjatë regjistrimit të votave nga ana e komisionereve, nuk janë numëruar në mënyrë të rregullt votat nga ana e komisionerëve për këtë arsye dyshon se i janë vjedhur votat.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat re lendes, ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për subjektet politike dhe të gjithë kandidatët e tyre për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj, PZAP-i më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendosi si në pjesën II të dispozitivit të vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 681/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.